

RELACION SHPJEGUES

PËR

PROJEKTLIGJIN

**“PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.9669, DATË
18.12.2006, “PËR MASAT NDAJ DHUNËS NË MARRËDHËNIET
FAMILJARE”, TË NDRYSHUAR**

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Arritja e barazisë gjinore si dhe minimizimi i dhunës ndaj grave e vajzave si dhe dhunës në marrëdhëniet familjare përbëjnë një prioritet të rëndësishëm, të lidhura ngushtë me proceset integruese të vendit.

Përpjekjet për të avancuar drejt barazisë gjinore dhe tolerancës zero kundër dhunës me bazë gjinore e dhunës në familje, synojnë përmirësimin e mëtejshëm të bashkërendimit me partnerët qeveritarë dhe aktorë të tjerë të interesuar, të angazhuara në mënyrë specifike për trajtimin dhe ofrimin e shërbimeve në lidhje me këto çështje, vënien në dispozicion të burimeve njerëzore e financiare për sigurimin e shërbimeve të mjaftueshme e të aksesueshme si dhe ngritjen e mekanizmave monitorues efektivë e të qëndrueshëm.

Nëpërmjet kësaj nisme ligjore synohet:

- a) reduktimi i rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare e në njësinë shtëpiake dhe mbrojtja e veçantë e pa diskriminim e çdo grupi që paraqet nevoja të veçanta mbrojtjeje;
- b) parashikimi i masës së largimit nga banesa të dhunuesit si masë më vete dhe të zbatueshme detyruesisht në çdo rast.
- c) sanksionimi i masave rehabilituese ndaj dhunuesit me fokus të veçantë dhunuesit e alkoolizuar, të droguar ose me probleme të shëndetit mendor dhe monitorimi i ecures së zbatimit të tyre.

II. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT DHE EFEKTET E PRITSHME

Në përmbushje të detyrimeve të Konventës së Stambollit dhe në vijim të rekomandimeve të Raportit të Vlerësimit të GREVIO-s, në Korrik të vitit 2018 Kuvendi i Shqipërisë, miratoi disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9669/2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”. Këto ndryshime ligjore kishin si qëllim:

- Garantimin e mbrojtjes së barabartë para ligjit dhe për qasje në mjete juridike të drejta dhe efektive;
- Harmonizimin e përkufizimit të dhunës në familje me Konventën dhe adresimin në përputhje me Konventën e Stambollit, të të gjitha formave të dhunës ndaj grave në mënyrë gjithëpërfshirëse;
- Hartimin dhe zbatimin e programeve të specilizuara për edukimin e autorëve të dhunës në familje me qëllim parandalimin e dhunës së mëtejshme dhe ndryshimin e sjelljeve të dhunshme;
- Sigurimin e bashkëpunimit ndërinstitucional ndërmjet të gjithë mekanizmave referues, dhe pajisja e të gjitha bashkive me një mekanizëm referimi plotësisht funksional;
- Ngritjen e qendrave të referimit të rasteve kundër dhunës, ku të vihen në dispozicion kontrole mjeko-ligjore, në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtarisht;
- Miratimin e masave për të lehtësuar dhe garantuar viktimat e të gjitha formave të dhunës, qasje në kompensim.
- Rishikimin e dispozitave ligjore të UMM-ve për të siguruar që në situata të një rreziku të menjëhershëm, UMM-të të lëshohen pa vonesa të panevojshme për të garantuar sigurinë e viktimës dhe përfshirja e vlerësimit të rrezikut, në procedurën e lëshimit të urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes dhe urdhrit të mbrojtjes.
- Përfundimin e zbatimit të procedurave të pajtimit gjatë veprimeve të procesit për lëshimin e urdhrave të mbrojtjes;
- Sigurimin e aksesit në drejtësi viktimave të dhunës në familje nëpërmjet përfundimit nga taksat gjyqësore.

Me gjithë përpjekjet e pandalura për të përmirësuar legjislacionin penal dhe administrativ, në drejtim të rritjes së nivelit të mbrojtjes, zgjerimit dhe konsolidimit të gamës së shërbimeve të mbështetjes për viktimat apo rehabilitimin/riintegrimin e dhunuesve si dhe nismat konkrete për hartëzimin dhe ngritjen e ofrimit e

shërbimeve konkrete për viktimat dhe dhunuesit, rastet e dhunës, që jo rrallë herë kanë sjellë pasoja fatale për jetën e vajzave dhe grave, nuk po ulen.

Anketimi i realizuar nga OSBE-ja, në Mars të vitit 2019¹, si pjesë e një projekti të zbatuar në Europën Juglindore dhe Lindore, nxori në pah të dhëna shqetësuese për dhunën ndaj grave dhe vajzave në Shqipëri.

Studimi arrin në tre përfundime kryesore.

Së pari, se “normat dhe qëndrimet kulturore në Shqipëri mbështesin bindjen e grave ndaj burrave, dhe dhuna seksuale në marrëdhëniet intime partnere pranohet gjerësisht. Shumë gra në Shqipëri besojnë se gratë duhet t'i binden burrave të tyre, dhe dhuna seksuale brenda marrëdhënieve intime konsiderohet e përhapur dhe normale. Këto besime kontribuojnë në një mjedis ku dhuna ndaj grave tolerohet”.

Së dyti “dhuna ndaj grave është e raportuar më pak, dhe gratë nuk kanë qasje të vazhdueshme në shërbime ose duke marrë mbrojtje. Mekanizmi kombëtar i referimit është një hap në drejtimin e duhur për të adresuar këto pengesa, por duhet të bëhet më shumë në zhvillimin e kapacitetit të plotë të këtij sistemi”.

Së treti: boshllëqe në legjislacion, në zbatimin e tij dhe në mbledhjen e të dhënave.

Sipas të dhënave të publikuara nga INSTAT, ka një rritje të vazhdueshme të numrit të rasteve të regjistruara të dhunës në familje nga 1.998 raste në vitin 2010 deri në 4.951 raste në vitin 2018. Gjatë tre viteve të fundit (2016- 2018), ka pasur një rritje të vazhdueshme me 9% çdo vit të numrit të rasteve të regjistruara të dhunës në familje².

Episodet e përsëritura të dhunës në familje dhe asaj me bazë gjinore, veçanërisht rastet kur dhuna përsëritet edhe ndaj grave që kanë përfituar urdhër mbrojtje nga gjykata, deri në humbjen e jetës, janë këmbanë alarmi për ndërhyrje të menjëhershme në legjislacion me mekanizma që forcojnë masat kundër dhunës.

¹ Studimi më i fundit i OSBE (2019) mbi dhunën ndaj grave në Shqipëri

² Raporti INSTAT 2019 për dhunën me bazë gjinore Dhuna ndaj Grave dhe Vajzave në Shqipëri - studim i INSTAT dhe PNUD botuar në Mars 2019

Nga të gjitha studimet mbi dhunën ndaj grave del si domosdoshmëri izolimi i dhunuesve dhe krijimi i një distance efektive midis dhunuesit dhe viktimës për të mos përsëritur dhunën.

III. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI

Projektligji është në përputhje me nenet 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës. Bazuar në parashikimet e nenit 81 pika 1 të Kushtetutës, projektligji propozohet si nismë deputeti.

Projektligji hartohet në përputhje me qëllimin strategjik 3, “Zvogëlimi i dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje”, Objektivi 3.3.1 “Përmirësimi i kuadrit ligjor në lidhje me dhunën me bazë gjinore dhe dhunën në familje” të Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2016-2020.

IV. VLERËSIMI I PËRPUTHSHMËRISË SË PROJEKTLIGJIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE

Projektligji nuk përafron e nuk lidhet me asnjë acquis të Bashkimit Evropian. Pavarësisht kësaj projektligji synon realizimin e disa prej objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm të Agjendës 2030 të shteteve anëtare të Kombeve të Bashkuara, përkatësisht objektivi nr. 5/SDG 5, “*Arritja e barazisë gjinore dhe fuqizimi i të gjithë grave dhe vajzave*” dhe objektivit 16: “*Nxitja e shoqërive paqësore dhe gjithëpërfshirëse për zhvillim të qëndrueshëm, ofrimi i mundësisë për drejtësi për të gjithë dhe ngritja e institucioneve të efektshme, llogaridhënëse dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet*”

V. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektligji është i strukturuar në 5 dispozita.

Neni 1 propozon disa ndryshime në dispozitën përkatëse që trajton masat mbrojtëse të dhunës në marrëdhëniet familjare. Dispozita parashikon si masë të parë dhe kryesore e mbrojtjes ndaj dhunës në familje, largimin menjëherë të

paditurin (dhunuesin/en) nga banesa për një afat kohor të caktuar me urdhër të gjykatës dhe mos lejojimin e tij të rihyjë në banesë pa autorizimin e gjykatës.

Kjo dispozitë merr në konsideratë dy aspekte të rëndësishme: nga njëra anë të drejtën për strehim të dhunuesit dhe nga ana tjetër të drejtën për garantimin e jetës dhe shëndetit të viktimës si një prej të drejtave themelore të njeriut.

Në fakt e drejta për strehim është e drejtë e njeriut, por si çdo e drejtë e ngjashme, nuk mund të jetë e pakufizuar.

Neni 17/1 i Kushtetutës parashikon se “kufizime të të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj, për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë”

Jurisprudenca kushtetuese, veçanërisht për sa u takon mjeteve të përdorura, është shprehur se ligjvënësi duhet të zbatojë mjete të tilla ligjore, të cilat duhet të jenë efektive, d.m.th. të zgjedhura në mënyrë të tillë që të jenë të përshtatshme për realizimin e synimeve që ndiqen. Përdorimi i këtyre mjeteve duhet të jetë i domosdoshëm, gjë që do të thotë se synimi nuk mund të arrihet me mjete të tjera. Domosdoshmëria ka të bëjë, gjithashtu, edhe me përdorimin e mjeteve më pak të dëmshme për subjektet që u cenohen të drejtat dhe liritë. Kushti i përpjesëtimit të kufizimit me gjendjen që e ka diktuar, konkretizohet në kërkesën e domosdoshmërisë, dobishmërisë dhe proporcionalitetit, në kuptimin strikt të kufizimeve të imponuara.

Vetë GJEDNJ në jurisprudencën e vet ka sanksionuar se të drejtat e njeriut mund të kufizohen në rast se kjo është e nevojshme në demokraci, por ky kufizim duhet të parashikohet në ligj dhe të jetë në proporcion të drejtë me synimin që kërkohet të arrihet.

Në rastet e dhunës në familje, nisur nga situatat alarmante dhe shifrat në rritje, justifikohet marrja e kësaj mase si proporcionale me problematikat e hasura, dhe si e tillë duhet parashikuar në ligj. Për këtë çështje nevojitet një diskutim për angazhimin e Bashkive, që në tilla raste në programet e strehimit të krijohet mundësia e strehimit të përkohshëm të dhunuesve, pasi nuk mund të lihen pa strehim në rastet kur kanë potencial për ridhunim. Programe të përbashkëta për rehabilitimin dhe strehimin e dhunuesve duhen marrë në konsideratë nga ministria përgjegjëse për çështjet sociale dhe bashkitë.

Një tjetër masë ligjore e trajtuar nëpërmjet kësaj nisme është edhe parashikimi i bërë në **nenin 2**. Nëpërmjet kësaj dispozite sanksionohet detyrimi i dhunuesve për të ndjekur programe rehabilitimi, që në momentin e ndalimit (para se të procedohen), gjatë kryerjes së dënimit dhe pas vuajtjes së dënimit. Kjo masë

parashikohet si një mundësi në ligj dhe vendoset nga gjykata, por për të rritur mbrojtjen dhe evituar përsëritjen e dhunës cmojmë se duhet parashikuar si e detyrueshme në ligj. Dispozita parashikon që përgjegjësit e programit të rehabilitimit të raportojnë përpara koordinatorit vendor për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, pjesëmarrjen e të paditurit në program dhe ecurinë e tij, në mënyrë periodike si dhe në përfundim të programit, në të cilin të përfshihen rezultatet e rehabilitimit të dhunuesit.

Neni 3 i këtij projektligji parashikon që në urdhrin për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme, që nxirret nga titullari i strukturës përgjegjëse të Policisë së Shtetit, në juridiksionin e së cilës është raportuar dhuna, të parashikohet si masë edhe urdhërimi për largimin e dhunuesit/es nga banesa derisa gjykata të nxjerrë urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes ose urdhrin e mbrojtjes. Kjo masë nuk cënon të drejtën e dhunuesit për një proces të rregullt ligjor, pasi është në çdo rast gjykata e cila brenda 48 orëve vlerëson masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme.

Në masë tjetër e cila propozohet nëpërmjet **nenit 4**, është edhe detyrimi i organit të policisë, ku viktimat paraqitet për herë të parë si ankuese, për të referuar rastin për ndjekje penale në organin e prokurorisë. Kjo do të bëjë që prokuroritë të marrin në hetim çdo rast dhe nisur nga rëndësia e shkeljes së pretenduar të kërkojnë më shpesh masën e arrestit për dhunuesit me rrezikshmëri për përsëritje apo për kryerjen e veprave penale më të rënda. Këto situata do ndikojnë në izolimin e dhunuesve dhe në të njëjtën kohë do shërbejnë si shembuj frenimi për të tjerë që janë të prirur drejt dhunës.

VI. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Brendshme (Policia e Shtetit) dhe njësitë e qeverisjes vendore (Bashkitë) nëpërmjet Mekanizmave të Koordinuar të Referimit të rasteve të Dhunes në Familje për zbatimin e këtij projektligji.

VII. HARTIMI I PROJEKT-AKTIT

Ky projektligj është hartuar me kontributin e deputeteve nismëtare, në bashkëpunim me ekspertët e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në cilësinë e ministrisë përgjegjëse për çështjet e barazisë gjinore dhe luftës kundër dhunës në familje, nën kujdesin e ministres.

VIII. RAPORTI I VLERËSIMIT TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Projektligji i propozuar nuk mbart efekte financiare shtesë për buxhetin e shtetit.

DEPUTETËT PROPOZUES

KLOTILDA BUSHKA (FERHATI)



EGLANTINA GJERMENI

